



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2021:027548

Datë: 05.06.2024

Numri i dokumentit: 05791655

KF.nr.413/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti Fiskal, me gjyqtaren Vera Gashi Bala, në kontestin tregtar - administrativ të paditësit, "Ylli Com" ShPK me numër të biznesit 70772833 me seli në fshatin Pozharan, Viti, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Liman Musa avokat, kundër të paditurës Dogana e Kosovës në Prishtinë, me bazë juridike anulim vendimi, vlerë kontesti 41,840.90 euro, në seancën e shqyrtimit gjyqësor kryesor – Publik, të mbajtur me datë 16.05.2024, në prani të përfaqësuesit të autorizuar të palës paditëse Avokat Liman Musa përfaqësuesit të autorizuar të palës së paditur Krenare Shala, mori, këtë:

A K T G J Y K I M

- I. APROVOHET kërkesëpadia e paditësit "Ylli Com" ShPK me numër të biznesit 70772833 me seli në fshatin Pozharan, Viti, si e bazuar.
- II. ANULOHET Aktvendimi nr.01.3.2.2/13818 të datës 22.01.2021, i Doganës së Kosovës në Prishtinë, dhe çështja kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje tek e paditura.
- III. Secila palë i bart shpenzimet e veta procedurale.

Arsyetim

Paditësi, me padinë e paraqitur në Gjykatë më 12.02.2021, ka iniciuar kontestin tregtar administrativ kundër të paditurës Dogana e Kosovës në Prishtinë, duke kundërshtuar Aktvendimin nr. 01.3.2.2/13818 të datës 22.01.2021, për shkak të shkeljeve absolute të dispozitave të LPA-së. Si në padi, ashtu edhe gjatë seancës së shqyrtimit gjyqësor dhe në fjalën përfundimtare, paditësi deklaroi se mbetet pranë padisë dhe kërkesëpadisë lidhur me vendimin e atakuar. Paditësi njoftoi gjykatën

se për të njëjtën çështje, lidhur me normativën, posedojnë vendimin e formës së prerë për të njëjtin subjekt dhe për të njëjtën bazë, të zbatuara nga Dogana e Kosovës. Padiësi theksoi se këto vendime, ku janë kthyer mjetet në procedurë, janë vërtetuar në të gjitha instancat gjyqësore. Ai i propozon gjykatës që të aprovojë padinë si të bazuar, të anulojë vendimin kontestues dhe të obligojë Doganën e Kosovës të kthejë pagesën prej 41,840.90 euro. Padiësi gjithashtu theksoi se sa i përket pretendimeve të paditurës që kundërshton normativin bazuar në vitin 2019, ekzistojnë vendime të gjykatës që kanë pranuar normativin dhe padiësit i janë kthyer mjetet, vendime të cilat janë dorëzuar gjykatës. Padiësi i propozon gjykatës që t'ia falë besimin pasi kjo çështje është trajtuar nga gjykata dhe ka marrë formë të prerë, dhe se e paditura ka përmbushur kërkesën konform aktvendimeve të gjykatës dhe ka kthyer mjetet. Padiësi kërkoi edhe taksat gjyqësore sipas përlllogaritjes përfundimtare të gjykatës.

E paditura, në përgjigje në padinë të datës 21.02.2022, e konteston në tërësi si të pabazuar kërkesëpadinë e padiësit. E paditura shtoi se aktvendimi është marrë në bazë të dispozitave ligjore në fuqi dhe se vendimi i kontestuar është marrë konform legjislacionit në fuqi dhe në mënyrë të drejtë, ndërsa pala padiëse nuk ka vërtetuar pretendimet e veta me asnjë provë. Përfaqësuesi i palës së paditur në seancën e shqyrtimit kryesor dhe në fjalën përfundimtare deklaroi se kundërshtojnë në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë si të pabazuar, duke shtuar se mbasin pranë përgjigjes në padi pasi vendimi i atakuar është marrë konform legjislacionit në fuqi dhe në mënyrë të drejtë. Sektori i akcizave gjatë analizës së shfrytëzimit të gazit propan butan ka konstatuar se kjo kompani gjatë periudhës 01.05.2019-31.12.2019 ka prodhuar 5,989,024 copë bukë standarde dhe 2,281,273 copë bukë të Shqipërisë, ku sipas deklaramit të padiësit janë shpenzuar 800,215.18 kg gaz propan butan, ndërsa nga data 01.01.2019-30.12.2019 kompania importuese është furnizuar me sasinë prej 1,118,040 kg propan butan. Bazuar në shpenzimet e deklaruara të prodhimit dhe normativit, është konstatuar se gazi propan butan nuk është shpenzuar sipas normativave nga komisioni për përcaktimin e normativit. E paditura i propozon gjykatës që pas administrimit të provave të marrë aktgjykim me të cilin refuzohet në tërësi si e pabazuar padia dhe kërkesëpadia e padiësit dhe të lë në fuqi vendimin kontestues si të ligjshëm dhe të drejtë.

Me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, gjykata në procedurën e provave të shqyrtimit kryesor-publik të datës 16.05.2024 ka administruar provat relevante si në vijim:

Gjykata vlerësoi ligjshmërinë e vendimit kontestues, thënieve në padi, përgjigjes në padi, dhe shkresave të lëndës në këtë konflikt administrativ, dhe konstatoi se kërkesëpadia është e bazuar.

Nga arsyetimi i vendimit kontestues, gjykata konstaton se e paditura ka arsyetuar se sektori i akcizave gjatë analizës së shfrytëzimit të gazit propan butan, ka konstatuar se kjo kompani gjatë periudhës 01.05.2019-31.12.2019 ka prodhuar 5,989,024 copë bukë standarde dhe 2,281,273 copë bukë të Shqipërisë, ku sipas deklarimit të subjektit janë shpenzuar 800,215.18 kg gas propan butan. Tutje ka theksuar se kompania ka deklaruar se ka shpenzuar në prodhim sasinë prej 800,215.00 kg gaz propan butan, ku sasia prej 32,510.00 kg është sasi për të cilën është paguar taksa e akcizave sipas harxhimit të deklaruar nga subjekti prodhues dhe për këtë sasi nuk bëhet inkasimi i akcizës. Andaj në bazë të shpenzimeve të deklaruara të prodhimit dhe normativave, gazi propan butan nuk është shpenzuar sipas normativave nga Komisioni për përcaktimin e normativit, andaj për këtë sasi duhet të inkasohen taksat. E paditura në vendimin kontestues ka sqaruar se duke analizuar makineritë prodhuese ka aplikuar metodën krahasimore me makineri të ngjashme dhe identike, andaj mbi këtë bazë janë të qëndrueshme normativat e aplikuar nga Dogana e Kosovës.

Pala paditëse i ka ofruar gjykatës dokumentin për përlogaritjen e harxhimit të lëndës djegëse gas propan butan të datës 01.04.2019 nga Enti Mlinpek Zavod nga Novi Sadi, me të cilin është bërë përlogaritja e harxhimit të lëndës djegëse për nevojat e prodhimit të produkteve nga furraria Ylli Com ShPK Pozharan, Komuna e Vitisë. Në këtë vlerësim janë cekur të dhënat teknike për furrën, harxhimin ditor të lëndës djegëse, harxhimin në nxemjen e furrës dhe gjatë pjekjes, dhe në fund është dhënë harxhimi për njësi të prodhimit të produkteve. Këto shpenzime të sasisë së gazit gjatë procesit të prodhimit nuk janë kontestuar në seancën gjyqësore nga i autorizuari i paditurës, dhe nuk ka ofruar ndonjë provë tjetër që do të dëshmonte se e paditura ka bërë një vlerësim konkret të shpenzimeve të sasisë së gazit tek paditësi. Gjykata e konsideron këtë dokument si provë materiale të mjaftueshme lidhur me normativin e shpenzimeve të deklaruar nga paditësi për vitin 2019, pasi që e paditura në këtë rast bart detyrimin e vërtetimit të fakteve që e mbështesin vendimin.

Gjykata vlerëson se vendimi kontestues nuk përmban arsyetim konkret dhe nuk ka arsyetuar se cilat janë ato kompani me të cilat është krahasuar paditësi, nuk ka bashkangjitur provat relevante për të mbështetur pretendimet e veta. Të vetmin arsyetim të cilin e ka dhënë e paditura në vendimin kontestues është se ka analizuar makineritë prodhuese duke aplikuar metodën krahasimore me makineri të ngjashme dhe identike, andaj mbi këtë bazë normativat e aplikuar nga Dogana e Kosovës janë valide dhe të bazuara në analizë krahasimore.

E paditura i ka bashkangjitur përgjigjes në padi Raportin e Kontrollit të datës 30.05.2018 të ATK-së, Regjioni Gjilan, ku është bërë kontrolli për periudhën 2014-2018, dhe sipas këtij raporti rezulton se nga ATK është kryer verifikimi i stokut më 28.05.2018 dhe nuk është hasur në mungesë apo tepricë materiale.

Prandaj nga të gjitha provat e administruara në këtë konflikt administrativ, gjykata vlerëson se e paditura nuk ka siguruar asnjë provë materiale për të dëshmuar dhe argumentuar arsyen e tatimit për akcizën dhe TVSH në vlerë totale prej 41,840.90 euro. Nuk ka dëshmuar se kur komisioni e ka vizituar paditësin me qëllim të vlerësimit se makineria e prodhimit është e njëjtë me makineri të tjera. Nuk ka arsyetuar dhe nuk ka bashkangjitur provat relevante se prodhimtaria e paditësit është identike me kompanitë me të cilat është bërë krahasimi. Nuk ka evidentuar se cilat janë ato kompani, cila është makineria dhe prodhimtaria e deklaruar dhe analizuar nga e paditura.

Një konstatim i tillë nga e paditura do të duhej të bazohej në prova dhe dëshmi konkrete, dhe jo të mbështetej në një konstatim abstrakt. Arsyetimi i tillë i paqartë dhe kontradiktor është i barasvlershëm me mungesë të arsyetimit, e që paraqet shkelje në dëm të paditësit dhe pa evitimin e të cilës nuk mund të procedohet tutje.

Të metat e lartcekura janë të tilla që e pengojnë vlerësimin e ligjshmërisë së vendimit të kontestuar, prandaj gjykata në rivendosje e obligon të paditurën që të deklarohet lidhur me çështjet e theksuara më lart.

Bazuar në nenin 81.F par.2 të ligjit Nr.04/L-102 të Udhëzimit Administrativ për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Administratën Tatimore dhe Procedurat Nr.03/L-222, *“Administrata tatimore, doganore ose ndonjë administratë tjetër kompetente do të bart detyrimin e vërtetimit të fakteve të cilat e mbështesin vendimin dhe kundërshtojnë kërkesën e tatimpaguesit”*. Neni 7, paragrafët 1 dhe 3 të Ligjit për Procedurën Kontestimore nr. 03/L-006 parasheh se: *“Palët kanë për detyrë të paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë me të cilat konstatohen faktet e tilla”*.

Gjykata vendos për çështjen e konfliktit administrativ në bazë të fakteve të vërtetuara në procedurë administrative, në përputhje me nenin 43, paragrafi 1, të LKA-së. Në bazë të këtij parimi, gjykata e ka të pamundur të vendosë në mënyrë meritore në këtë konflikt administrativ për arsye se ekzistojnë të meta që e pengojnë vlerësimin e ligjshmërisë së vendimit të kontestuar.

Andaj gjykata aprovon padinë e paditësit, anulon aktvendimin e kontestuar dhe lënda kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje.

Sipas nenit 43, paragrafi 2, të LKA-së, përcaktohet se: *“Nëse gjykata konstaton se konflikti administrativ nuk mund të shqyrtohet në bazë të fakteve të vërtetuara në procedurën administrative për shkak se në pikëpamje të fakteve të vërtetuara ekzistojnë kontradikta në akte, gjë që në pikat esenciale nuk janë vërtetuar plotësisht, ose konstaton se në procedurën administrative nuk janë respektuar rregullat e procedurës, që do të kishin rëndësi për zgjidhjen e çështjes, gjykata do të anulojë me aktgjykim aktin e kontestuar administrativ. Në një rast të tillë, organi kompetent ka për detyrë të veprojë ashtu si është caktuar në aktgjykim dhe të nxjerrë akt të ri administrativ”*. Andaj, gjykata bazuar në autorizimet nga neni 43, paragrafi 2, të LKA-së e detyron të paditurën që në ri-procedurë të veprojë sipas vërejtjeve të dhëna në arsyetimin e këtij aktgjykimi.

Vërejtjet e cekura janë të obligueshme për organin e paditur, duke u bazuar edhe në nenin 65 të Ligjit për Konfliktet Administrative.

Vendimin që secila palë të bartë shpenzimet e procedurës, gjykata e ka mbështetur në dispozitat e nenit 64 të LKA-së nr.03/L-202 për Konfliktet Administrative.

Nga sa u tha më lart, gjykata, konform nenit 43, paragrafi 2, dhe nenit 46, paragrafët 1, 2 dhe 3, të LKA-së, ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS  
Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti Fiskal  
KF.nr.413/22, datë 16.05.2024

Gjyqtarja  
Vera Gashi Bala

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi, është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi, dhomave të shkallës së dytë, përmes dhomave të shkallës së parë të kësaj Gjykate.